



## SISTEMI RECETES ELEKTRONIKE



- **Synimi i projektit eRX**
- **Hapat teknike per procesin e recetes elektronike - MJEKU**
- **Hapat teknike per procesin e recetes elektronike - FARMACIA**
- **Avantazhet dhe risite**

**Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor**

Adresa: Rruga "Sami Frasheri", nr. 8, Tirane

Tel: +3554223815 | Fax: +35542274953

[www.fsdksh.com.al](http://www.fsdksh.com.al)


e-mail: [info@fsdksh.com.al](mailto:info@fsdksh.com.al)

## • Synimi i projektit eRX

- Gjenerimi, transmetimi, dhe plotësimi i recetave mjekësore bazuar tek infrastruktura elektronike, duke zëvendësuar përdorimin e recetave letër.
- Receta elektronike e lejon mjekun, të krijojë dhe të transmetojë në mënyrë elektronike një recetë si dhe farmacistin të ekzekutojë në mënyrë elektronike recetën.
- Sistemi i e-Rx lejon FSDKSH-në të monitorojë, kontrollojë dhe të Rimbursojë recetën elektronike.
- Projekt Pilot në 18 QSH dhe 80 Farmaci në Durrës
- Projekti është bazuar në eksperiencën të suksesshme të vendeve të BE
- Realizohet vetëm për recetat me rimbursim dhe barnat nga LBR 2015
- Funkcionon për pacientët e pajisur me Kartë Shëndeti
- Realizohet vetëm në QSH dhe farmacitë e rrjetit të hapur që kanë kontratë me FSDKSH

## • Hapat teknike për procesin e recetes elektronike - MJEKU

- Hyjme në sistem nëpërmjet internetit në komunikim të sigurtë nga FSDKSH ,
- Mbas të hapet ky link bëjmë identifikim personal duke vendosur (Username/Password)
- Mbas aksesimit në e-Rx do të na shfaqen këto butona:
  - eRx
  - Mjeku (profili)
  - Pacientet
  - Qendra Shëndetësore
  - Ndhime
  - Librari



- Shtypim butonin eRX
- Në ekran do të shfaqet tabela **‘Kerko me NID’** dhe pasi plotësohet fusha NID klikohet butoni **“Kerko”** për të marrë të dhënat anagrafike të pacientit
- Pasi vendoset NID të dhënat e pacientit shfaqen në ekran që vijne nga Sistemi i Gjendjes Civile, kodi i pacientit dhe kategoria e pacientit vijne nga regjistri i Elektronik i Kartave nga FSDKSH si dhe plotësohen fushat pesha, Dt. Fillimit të sigurimit, Dt. Mbarimit të sigurimit, dhe shtypim butonin **“Ruaj”**.
- Në tablinë e pacientëve është e mundur të kërkohet një pacient nga historiku i kategorive dhe diagnozave për receta që janë lëshuar për këtë pacient.
- Pasi është zgjedhur pacientin kërkohet në tablinë Receta, ku shtypet butoni **“Shto Recete të Re”** për të shtuar një recetë të re.
- Këtu shfaqet lloji i recetës **“Me rimbursim”** apo **“pa Rimbursim”** përzgjidhet tipi i recetës **“Akute”** apo **“kronike”**, zgjidhet **diagnoza** (ICD 9), përcaktohet periudha e vlefshmërisë së recetës **“1 mujore”** apo disa mujore, përshkrimi për këtë recetë dhe shtypet butoni **“Ruaj”** për të ruajtur të dhënat.
- Mbas plotësimit të të dhënave mbi recetën shtypim butonin **“Shto”** për të shtuar kolonën mbi të dhënat e medikamentit të kësaj recete.
- Në kolonën e shfaqur klikojmë mbi butonin kerko Për të Shtuar Principin aktiv të medikamentit ku në ekran tregohet përzgjedhja ose kërkimi i medikamentit
- Mbas zgjidhet principi aktiv bëhet plotësimi i fushave mbi **“Terapinë e Rekomanduar”**, **“Sasine”** **“kohezgjatja e kurimit”**, dhe shënime mbi medikamentin dhe shtypet butoni **“RUAJ”** për të ruajtur të dhënat. Pastaj shtohen medikamente të tjera nëqë do të rekomandohen dhe shtypet butoni **“RUAJ”** për të ruajtur të dhënat finale.
- Mbas bëhet dhe njëherë kontrolli mbi të dhënat bëhet konfirmimi i kësaj recete dhe mbas këtij veprimi nuk do të mund të bëhen më ndryshime në këtë recetë.
- Pasi është bërë konfirmimi i recetës atëherë shtypet butoni **Printo Recete** për të shkarkuar një kopje elektronike ose printuar recetën.
- Më pas mjeku mund të rishikojë statusin e tij me raportet e nxjerra duke verifikuar dhe rakorduar veprimet e tij në sistem tek komandat **“PROFILI IM”**.



15524220258727

Dt. vlefshmërie nga : 24.05.2015

Dt. vlefshmërie deri : 31.05.2015

Tipi i Recetes : Me rimbursim

#### Të dhënat e mjekut

Emri Mbiemri : Fredi Guga  
Kodi i mjekut : 35  
Qendra  
Shëndetësore : QSH Nr. 1

#### Të dhënat e pacientit

Emri Mbiemri : KUJTIM MEÇA  
Kategoria : I punesuar  
Kodi i Pacientit : 710354523  
Datëlindja : 27.07.1958

Diagnoza : A6 B25 Fear of aids/HIV

#### Plotësuar nga mjeku

1	<b>Principi aktiv: AMOXICILLIN (as AMOXICILLIN TRIHYDRATE) 500mg</b> Terapia e rekomanduar: 1*2 Sasia: 20 Kohëzgjatja e Kurimit: 10 dit Çmimi i rekomanduar i barit për njësi: 13.8 L Forma: capsule, hard Shënime: pas buke
2	<b>Principi aktiv: RANITIDINE 150mg</b> Terapia e rekomanduar: 1*2 Sasia: 20 Kohëzgjatja e Kurimit: 10 dit Çmimi i rekomanduar i barit për njësi: 18.7 L Forma: coated tablet Shënime: pas buke

#### Plotësohet nga farmacisti

Emërtimi Tregtar	Sasia	Çmimi	Totali


Data e recetës : 24.05.2015

Mjeku : Fredi Guga


Firma/ Vula: \_\_\_\_\_

## • Hapat teknike per procesin e recetes elektronike - FARMACIA

- Hyjme ne sistem nepermjet internetit ne komunikim te sigurte nga FSDKSH ,
- Mbasi te hapet ky link bejme identifikim personal duke vendosur (Username/Password)
- Mbas aksesimit ne e-Rx do te na shaqen keto butona:
  - Receta farmaci
  - Farmaci
  - Ndihe
  - Librari



- Shtypet butoni receta farmaci dhe me pas ne tabin Kerko, skanohet me ane te barcode reader ose shkruhet barkodi i recetes te dhene nga pacienti, dhe shtypet butoni Kerko,
- Ne menyre automatike este shfaqur receta e plotesuar nga mjeku per kete Pacient
- Tek seksioni barnat e dhena nga farmacisti, klikohet butoni “Ekzekuto” dhe konfirmohet ekzekutimi i kesaj recete.
- Mbas perzgjedhjes se butonit ekzekuto do te shfaqet tabela ku konfirmohet ekzekutimi i kesaj recete ne kete farmaci
- Mbas ekzekutimit behen aktive fushat e perzgjedhjes se barnave dhe fillohet plotesimi i recetes nga farmacisti.
- Klikojme mbi butonin kerko dhe fillojme perzgjedhjen e alternativave te barit
- Perzgjidhet njera nga alternativat e shfaqura per kete princip aktiv, referuara LBR 2015
- Vendoset sasia qe i referohet sasise se paketimit
- Klikojme mbi butonin “search” dhe pastaj OK
- Vazhdojme ne te njeten menyre ne perzgjedhjen e barnave per kete recete
- Mbas perfundimit te plotesimit te te gjitha alternativave japim komanden “Ruaj” dhe do te shfaqet informacioni i ruajtjes me sukses se ketij procesi.
- Mbas konfirmimit me sukses te kesaj recete sdo te kete me mundesi per tu ndryshuar kjo recete, dhe ne kete moment behet e vlefshme butoni Printo
- Mbasi klikojme butonin Printo do te kemi receten e printuar



Dt. e vlefshmërisë nga : 27.05.2015  
Dt. vlefshmërisë deri : 03.05.2015  
Tipi : Me rimbursim te plote

155271442461223

**Të dhënat e mjekut**  
Emri Mbiemri : Fredi Guga  
Kodi i mjekut : 729859  
Qendra Shëndetësore : QSH Nr. 1  
Diagnoza : 0401 Hipertension esencial

**Të dhënat e pacientit**  
Emri Mbiemri : NAZMIE GJORDANI  
Kategoria : Pensionist  
Kodi i pacientit : 710217784  
Datëlindja : 23.12.2048

**Plotësuar nga mjeku**

	Principi aktiv: ENALAPRIL 10mg	Emërtim Tregtar	Sasia	Cmimi	Totali
1	Terapia e rekomanduar: 2* 1/2 Sasia: 60 Kohëzgjatja e Kurimit: 60 dit Cmimi i rekomanduar i bari për rreth: 12.1 L Forma: tablet Shënime: rritas bukë.	BERLIPRIL 10	1	0	0

**Plotësuar nga farmacisti**

	Principi aktiv: ATEKLOL 100mg	Emërtim Tregtar	Sasia	Cmimi	Totali
2	Terapia e rekomanduar: 1*1 Sasia: 60 Kohëzgjatja e Kurimit: 60 dit Cmimi i rekomanduar i bari për rreth: 12.7 L Forma: coated tablet Shënime: rritas bukë.	TENORMIN	1	9.9	9.9


Data e recepit : 27.05.2015  
Mjeku : Fredi Guga

Totali pacientit: 9.9 L  
Rimbursuar nga Fondi: 24.8 L  
Cmimi total i referencës: 34.7 L

**Të dhënat e farmacistit**  
Emri : Agj. Shkallnur  
NUTS : K31803508K  
Adresa : Shkallnur Durres

**Të dhënat e farmacistit**  
Emri Mbiemri : Lindita Hoxha  
Firma : \_\_\_\_\_

Në bazën elektronike të farmacistëve:  
aFOGdP7c5v8z5z9K5y9WMEFyaGQ880gaPpUv7065ANE0AdFvClj-u2pc0vC0pav77qech-6VAG8Up0z0d6a0D0eafP9V9UyL7v8iX80U005D  
R0U7tq\*\*  
DL 00001 28.04.2016 07:00



Page 1 nga 1

• **Avantazhet dhe risite**

- Rrit saktësinë në përcaktimin e barnave duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe të kosto-efektivitetit në trajtimin e pacientëve.
- U mundësinë e dhënies së gabuar të barnave për pacientët dhe mundëson ndërtimin e një sistemi alert në rastet e përshkrimit jo te sakte të barit, duke u mbështetur tek udhërrefyesit dhe protokollet përkatëse të miratuara.
- Ruan historikun për sëmundjen dhe trajtimin e pacientëve, duke lehtësuar mjekun për të gjykuar trajtimin medikamentoz në vazhdimësi.

- Redukton ndjeshëm kostot administrative për receten
- Eleminon fenomenin e recetave fiktive në rimbursim. Shmang abuzimet me recetat e rimbursuara.
- Bashkevepron online me insitucionet e tjera duke shtuar efektivitetin në manaxhimin e riskut.
- Ofron për FSDKSH në kohë reale informacion dhe raporte për barnat, recetat, mjekët dhe farmacistë për qëllime monitorimi dhe rimbursimi.
- Krijon një bazë të dhënash që mund të shërbejë për studime në fushat e ekonomisë shëndetësore, farmako ekonomise, shendet publik, etj.
- e-Receta përdor kanalet e komunikimit të sigurte elektronik ndërmjet mjekut, farmacistit dhe institucionit rimbursues për barna të caktuara

\*Materiali është përgatitur nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun në bashkëpunim me Drejtorinë e DIAS